



RADIO
TELEVIZIONI
SHQIPTAR

KËSHILLI DREJTUES I RTSH
NR. 2721 PROT

Tiranë më 16.09.2020

VENDIM
NR. 34, date 16.09.2020

Në zbatim të nenit 102 të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 “ Për median audiovizive ne RSH”, nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr 98, datë 22.12.2016 “ Për miratimin e Statutit të RTSH”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Bordi i Administrimit të RTSY me shkresën nr 2671 prot, date 14.09.2020, mbi miratimin e indeksimit (nga inflacioni i rezultuar përgjatë 6 viteve të fundit) në rritjen e pagave të punonjësve në sistemin e RTSH, në kuadër të zbatimit të Buxhetit të RTSH për vitin 2020 miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të RTSH nr. 1 datë 6.03.2020, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij datë 16.09.2020 me votimin pro të 6 anëtarëve të pranishëm K.Traja, Xh.Aliu, Xh.Mato H.Haliti, S. Kumbaro, dhe A.Shegani;

VENDOSI:

I. Të miratojë indeksimit (nga inflacioni i rezultuar përgjatë 6 viteve të fundit) në rritjen e pagave të punonjësve në sistemin e RTSH si më poshtë vijon:

- Pagat bruto deri në 50.000 lekë në muaj të rriten 10% në muaj
- Pagat bruto mbi 50.000 lekë në muaj të rriten me 5.000 lekë në muaj

II. Efektet financiare fillojnë nga data 1 shtator 2020.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Kristaq TRAJA